Lulëzim Haziri

DALJA NGA SAFARI

Biblioteka _____

Redaktor
Fatmir Sulejmani

Recensentë
Shazim Mehmeti
Salajdin Salihu

Design
Safet Spahiu

Tirazhi **1000 copë**

Lulëzim Haziri

DALJA NGA SAFARI

(Poezi)

BREZI9

2005

Iso e re

Kur me grep të artë nga fundi i barkut
Ia sollën shpirtin në fyt
E sosi të ngjitej shkallëve në podium
Të fliste me gjuhë të re
Që e dinin të gjithë në vetmi
Gjuhën e atyre që me majë këpucësh
Shkruanin hieroglifë mbi asfaltin e zi
Kur pritnin ngjarjen që nuk ndodhte kurrë

Mori leje nën llambat e neonit
Lëshoi flokët e besimit deri te thembra
Me syzet e zeza ua shkurtoi dritën lajkave
Dhe si heretik mitik me kitarë në krah
Nga gjuha tel hollë nxirrte zjarr
E një reflektor si aureolë i rrinte mbi kokë

Dora e zgjatur i arrinte në fund të sallës
(përshëndetej me të gjithë përnjëherë
Zëri i dëgjohej edhe përtej mureve
Që ishin në plan të rrënohen
Sytë e tyre kishin ngjyrën e syve të tij
Zëri i tyre kishte ngjyrën e zërit të tij
Ia mbanin ison e re pa pushim
Kur nga fundi i barkut klithte
"Kjo s'është këngë dashurie
  Kjo s'është këngë dashurie
. . . . . ."

Dyshimi pingul mbi kokë

Lutje

Këngën e këngëve të mia
Do t`ia kushtoj
Baltës në fund të shpirtit
Shpirtit në baltë
Që kutërbon një botë të tërë

Në barrikada

Na la
Barrikadave
Me pagjumësinë e Makondasve
Mbështetur ëndrrat në njëri-tjetrin si lumë
Sedra e postit e rëndoi
E dogji malli për gjumë qengji
Në kolltuk kundrejt televizorit
Mbështjellë me batanijen e fajit
Me rruazat e gruas si tespihe ne dorë
Dhe sy të varur-Sypërmbys

Në barrikada posta vjen me vonesë
Pijet nuk servohen në gota gjegjëse kristali
Shtyp të ilustruar s'ka as esspreso
Lajmet i bie era të censuruara
Si reporter lufte në TV

Na la
Me sëmundjen e pritjes në barrikada
Kishte shpirt të lehtë romantik
Lidhte kravata të mëndafshta rreth qafe
Epshi për gruan nimfomane e mbuloi
E thirrte shtrati e përvëlonte shtati i saj
Fisnike e kish s'ka fjalë
Besnike me fjalë
Na la të përgjumur e të përhumbur
Për erën e kafesë së mëngjesit

Në barrikada s'ka festival
Mbi gjak të ngjizur rrëshqitet atje
Shtëpinë e sheh fatamorganë
Mallin e fëmijëve e ruan në xhep në kuletë
E vdekja të flenë nën helmetë

Na la
Të nxirë në fytyrë nga tymi i shpresës
Që digjej si gomë kamioni në rrugë
Dëshironte në det të merrte ngjyrë bakri
Pa u skuqur e rrezitur lumenjve më parë
Syçelë shikonte ëndrra kashmiri
Se ish i sëmurë i operuar disa herë
Dru i transplantuar me mjeshtëri
Në kryet e strucit kishte sytë e deles
Zemrën e kish të lepurit
Bishtin e hardhucës
Tamam shëmti mitologjike

Kush flet atje

matet me hijen e mëngjesit
sypalari
krenaria i rri varur
si cigarja në buzët e hemfri bogartit

kur të gjithë mblidhen në shesh
të përshkojnë gishtat me mllef kah qielli
aq sa gjaku t'iu rrjedhë
ai mbledh shokët në aheng
iu shet mend me licencë

gjithkund gand e gjen
si engjëllin e kaltër sklebavec
më parë plot bujë i vjen firma
pastaj ai vet i trembëdhjeti

atë ditë që me cigare në gojë më përshëndet
shpinën në shtrat gruas ia kthej

në kohën e artë të Xhaxhait që u bënte lajka
plot flamuj në dorë mbanin
më tepër për inat të Babait
që i ngjizej gjaku për një zog

prilleve të përgjakshme me djemtë e Xhaxhait
me rroba jeshile shkonin në gjueti
kur pushonin nën lis
hanin mish viçi që ende tëmbël pi
me gjethe fshinin gjakun e çizmeve

sot
kafeneve e thërrasin
në krye i bëjnë vend
e qerasin
t'iu flasë me gjuhë të zjarrtë
në atë tryezë për mua s'ka vend
për gotën dhe gjuhën time të akullt
kristal

me filxhanin me lara në dorë
u tregon ç'kanë ngrënë mbrëmë
të nesërmen s'di t'ua lexoj
as në të njomat pëllëmbë
shkova të dëgjoj Eurithmics
When tomorrow comes

Etër e bij

(monolog etërish)

përngjajnë në pamje me ne ngapak
pasqyrë i kemi që na kënaq
shohim veten si mplakemi ngadalë
kur nisin e flasin mbrapshtë
toka nën këmbë na dridhet sakaq

herët ëndrrave u shkojnë brisk
fjalë këngësh nuk mbajnë në mend
andaj shkruajnë fasadave me sprej
s`para bëjnë art në pëlhurë
gjithë vrerin e derdhin në mur

sa pa ndjenja që janë
s`kanë dell as për romantikë
flenë si arusha deri në drekë
nuk e kanë parë diellin si lind

muzika e tyre i ka ca tinguj çeshit
merren vesh edhe me irlandezë
s`u mjafton një tel
pak i kanë edhe dymbëdhjetë

flamurit që valëvitet
s`i turren si ne
si dema të harlisur në arenë

kur një ditë të vdesim
krenarë pas kortezhit do të na vijnë
lot s`lëshojnë as për dashuri
kanë filozofinë e tyre *s`ka rëndësi*

kur nisen
rrugës kah u kthyem ne
në xhepa s`mbajnë fytyrat e të dashurve

edhe palltot tona të vjetra kur i veshin
në trup u rrinë shik
se ndjekin modën *si më teket*

dyshimin si shenjë Kaini e kanë në ballë
fjalëve të gishtave tanë s`u besojnë
shenjat e rrugës thonë na i ngatërruat
tërë farën ua derdhin grave në bark
asnjë pikë s`duan t`iu bjerë në Dhe

Heroi i heshtur fërshëllen një kaba në E-Dur(im)

T'u desh kohë e peshuar me shumë ofshamë
Të ndërrosh aq vagonë të përhimë
Përplot njerëz që flisnin bjer e ngrehu
O zot
Ata thoshin citate gazetash
Nga frika mos gabonin e dëgjonin
Ç'u thoshte mendja
Nga frika mos gjuhën e Prijësit e harronin

Korridoreve çave rrugën me bërryla
Vagonëve përplot shurdhmemecë me syze dielli
Të gjithë në xhepa kishin një libër
Zot
Të gjithë shikonin e s'shihnin
Si s'ndërrohej karrigia por vëllezërit
Me sytë e mjegulluar nga fytyra e Prijësit
Këndonin e pinin me të në gojë

Ti heshtje
Heshtja kryeneçe t'u ngul në tru
Ta zuri vendin e fjalës së zjarrtë
Trupit të vet për t'i dhënë trajtë

Nga metaforat e reja
Gjuha e Prijësit t'u duk pa gjini
Se ti kishe gjuhën ku fjala Dhe
Kish edhe Mëmë edhe Atë

Në bufenë e trenit dëgjoheshin marshe
Ti fërshëlleje një kaba në E-Dur(im)
Nga dritarja hodhe si një letër frikën
Dhe fjalorin e heshtjes e bëre copë

Mos incizo

Fqinjët më zgjojnë në ferk
Të shoh diellin mbi helmeta
Ora shkonte 9 korrik
Në këtë ditë puna nuk fillon në drekë
Dorë e hekurt është kujdesur për akrepat
Akrepat e Kullës ë Sahatit nuk punojnë për një çast
Bekim them merre kamerën
S'ka nevojë për white balance
Incizoi këto helmeta në park
Këto fytyra të skuqura për gjak
Dhe një helmetë më thotë:
Ej, ti, mos incizo
Ecim me Bekimin rrugëve të Gostivarit
Nën shikimin e helmetave krejt dyshim
Pyesin ç'bëjnë këta dy rrugëve
Mos dëgjo Bekim, vetëm incizo
Kapi ca fytyra përplot mllef
Kërbaçin e tyre nervoz në dorë
Ikni nga rruga në thonë mos incizo
Bjeri Bekim mos dëgjo
Këto fjalë nuk thuhen kot
Njëmijë helmeta heshtin vetëm njëra flet
Mos incizo
Nesër do të jetë vonë
Kjo orë është një, nuk vjen më
Kur të incizosh mos u ndal
edhe kur të thonë mos
Kjo është puna jonë
Mos u frikëso krisma janë këto
S'e kë parë Kosovën Bosnjën në televizor
Të lutem incizo
Gaz lotsjellës është ky
Nuk quhen këto lot
Nesër do të jetë pastër
Sot vetëm incizo
Plumba me sy janë këto nuk janë qorr
Të rëndë kanë hyrë në këtë orë
Ky korrik është nisur për këtu
S'e gjen në Prishtinë Vlorë as në CNN
Zogjtë ikin nga parku i klithmave
Autoambulancat lëshojnë kujë
Një plumb me sy përshkohet trupit të njomë
Spitali nuk ka gjumë
Shëron një qytet të përgjakur
Ku shkove Bekim incizo
ja gjaku i hequr zvarg rrugëve

Incizo ende nuk është ngjizur
Nesër do të jetë vonë
Rrugët do të lahen në mëngjes
Ky korri zgjat vetëm një ditë
Ia vlen të incizosh

Korrik '97

Klounët poetik

kanë hundë të ngjyrosur për cirk
qoftë edhe karnaval poetik
janë të prirë që çdo ideal
ta bëjnë të rëndomtë gati qesharak

të tjerët kur buzët paltojnë
të bindur se gjuha eshtra s'ka
se fjala pështymën ta than
klounët rropaten thonë gjithçka
të bëjnë për gaz po u shkove pas
arnat e Arlekinit t'i qepin mbas

Dëshmitari

shumëçka kam parë
më mirë verbomëni sytë

gjithçka kam dëgjuar
vaj të djegur hidhmëni në vesh

në e tregofsha atë që kam parë
atë që kam dëgjuar në e shkrofsha
Vardari nuk më lan

Nuk më lënë ta puth dyshimin në ballë

I.

Kur mbrëmja ulet këmbëkryq dhe kur dritat i çelin sytë
Hedh setrën e zhgënjimit krahëve të mërdhirë
Për dore marr vetminë e qes të shëtitë
Me shokët përfalem ftohtas në heshtje me shikim
Rrugët më zgjerohen para syve më shtohen (pikë) pamjet
Kur sodit nën këndin e drejtë a ndihem i qetë
Qepallat pulit pa ndarë pluhuri i mërzisë të mos më hyj në sy
Me xhelozinë e njelmët kërkoj biseda pa shije
Kur qeshem me zor kur zbardh dhëmbët e ironisë
A ndihem i huaj i vetmuar si cinik

II.

Më thanë se do të ha me lugë të artë
Premtuesve duhet t'ju kujtoj premtimet
A duhet t'u nxirren sytë si ushtarëve të Samuilit
Apo do t'i nxjerrin vetë si Edipi
Dënimin postieri e la në adresë të gabuar
Më mirë ta flak mbamendjen të vë sytë e deles
Gjellën ta ha me dorë me lugë druri
Sytë më mashtrojnë
Goja fjalët i gabon
Apo shtirem i tillë
Nuk më lënë ta puth dyshimin në ballë

III.

Qyteti është punëtor krahu që fle pa larë sytë
Ta lëmë të flejë i lodhur i pluhurosur në fytyrë
Trotuaret le t'i ruajnë puthjet të freskëta tërë natën
Shiritin e natës duhet ta lëmë deri në mëngjes të incizojë
E t'i dëgjojmë atëherë ëndrrat me veshët e ngrehur pip
Bisedat e dehura me erë shqetësimi kryeneç
Duke e pirë kafenë e mëngjesit
Të dyshojmë në sinqeritetin e pëshpëritjeve
Të folurit e përgjumur le të na shtjerë të mendojmë e dyshojmë
Pastruesit e rrugëve le të na shlyejnë shiritin në mëngjes
Ka lezet ta shohësh qytetin pa larë sytë
Atëherë me pagjumësinë e mëngjesit njësohem me të
Rritem bëhem i madh sa rrokaqielli
Që nga dhembja e mbrëmshme lidhi kryet me mahramë
Rrugët do larë kur njerëzit shkojnë në punë

Dielli të reflektohet nga pasqyra e zezë
Të më hyjnë në sy
Kurmin e lodhur të ma ndritë

IV.

Bëhem dhomë e ndritur plot orendi
Të vjetra sa mendimi të shtrenjta

V.

Ditë e mirë është kur zgjohem në jastëk flokësh
Ditë e mirë është kur zgjohem në drekë
Ditë e mirë është kur nuk blej gazetë
Ditë e mirë është kur pi kafe ekspres
Ditë e mirë është kur s'i laj sytë në mëngjes
Ditë e mirë është kur kam cilës t'i pëshpërit në vesh
Ditë e mirë është kur lë gjurmë në borë të pashkelur më parë
Ditë e mirë është kur nuk kamë çfarë të pres
Ditë e mirë është kur kam çfarë të them e s'e them dot
Ditë e mirë është kur gjej groteskun në natyrë
Ditë e mirë është kur s'kam kë ta tall
Ditë e mirë është kur i bishtëroj rreshtit për në të nesërmen
Ditë e mirë është kur nuk më japin asnjë lëvdatë
Ditë e mirë është kur sodit i qetë vesën në merimangë
Ditë e mirë është kur asnjë hije nuk më ndjek
Ditë e mirë është kur shkruaj ndonjë nokturno pastaj bie të fle
Ditë e mirë është kur shikoj qytetin me sytë e të papunit
Ditë e mirë është kur të shëmtuarës i buzëqesh ndër sy
Ditë e mirë është kur kënaqem me veten i shtrirë
Ditë e mirë është kur zgjohem lakuriq
Nga trupi e turpi
Lakuriq si Shpresa

VI.

Nuk më mban ky qytet i tillë siç jam i mrrolur i ftohtë
Kur eci rrugës e vij nën llambë ajo fiket
Kodrës së Diellit kur ngjitem të shikoj Qytetin ai tretet
Të iki nga këtu prej këtij qielli asfalt futë
Ku më parë gjen ndonjë iluzion se para të humbur
T'i kthehem natyrës të shkoj në bjeshkë
Të mos e marr me vete përditshmërinë urbane
Përsëritjen marramendëse ciklike të fjalëve gumëzhitëse
Të shoh si çelin lulet gjethi si zverdhet
A pendohet para se të bjerë në tokë lotin a e lëshon

(sa bukur tingëllon ky mashtrim)
Apo të mbyllem në dhomat e artit labirint
Me laps të mprehur të bëj bukurshkrim
Sytë e përgjumur të bëhen më të pasur për një ditë

VII.

Të mashtruar të ngrirë të verbuar
Këmbëzbathur kryeshtruar sykulluar
Përkrah vrapuam gjatë
Rrugës së drejtë të ndjenjave
Fusha e gjerë krahëhapur
Na priti si fëmijët e vet
Që janë vonuar 1001 vjet

Fusha u bë sy e vesh
Dëgjonte trillimet për ngjyrat
Për ëndrrat e harruara
Fshehurazi na shtronte shtratin
Buzë ndonjë lumi dredharak që derdhej diku larg
Nga pagjumësia nuhatnim lëngjet jetëdhënëse
Fiq të kuqërremtë haja për drekë

Këtu koha nuk matet me orë
Po me hijet që zgjaten e shkurtohen

Hëna rreth vetes yjet kur i mblodhi
Rreth zjarrit kënduam këngën e mërzisë
Yjet e fatit na pikuan në pëllëmbë
Për t'i sjellë nën llambat e neonit
Që loznin me hijet e zgjatura në mur

VIII.

Prej çastit kur Armstrongu u ngjit në hënë
Atëherë kur në TV i pashë gropat e saj
Që mu bënë si shkretëtira nga libri i Historisë
Në vjersha s'e përdora më fjalën hënë
Që e kisha sinonim të së bukurës që shndrit
Fjala humbi bukurinë që më flinte në fletore
Kur soditja nga dritarja e vjetër

IX.

Një ditë më vonë
Vëllezërit e mëdhenj me zemra anemike

Retë dhe tokën nën re
Do t'i plehërojnë me atom
Toka do të rrafshohet deri në paskajësi
Në këtë kaos frika vonon në takim
Kalorësve të tërbuar të apokalipsës
Frerët do t'u rrëshqasin nga duart
Uji tokës do t'i hyjë në palcë
Zogjtë do të na bëhen engjëj
Lajme diellit do t'i dërgojnë

Mbi këtë rrafsh të qullur mitologjik
Një milingonë do të mbijë nga toka
Hapat e saj të vegjël e të shkathët
Do të lënë gjurmë prapa
Një segment deri te njeriu
Që do të shkruajë në rërë gur dru
Pastaj do të shpikë rrotën
Dhe gjithçka do të rrotullohet

Shqipëria

me rërë të fundosur në krye të kthjellët
mora rrugën për ATJE
ndanë udhëve eshtrat lëshonin dritë
sipër kufijve frynin fjalë në erë
me radiovalë ish mbuluar qielli

ATJE vjen kah unë si me porosi
të më trazojë rërën në kokë
fjalë të më fryjë në vesh
zhgënjimi si do t'u dalë ndeshë

vërtet një shikim është dashuri
po dashuria nuk është një shikim

Qafëthanë, 1991

Peshk i vetëm në akuarium

(prolog)
nga flora këtej xhamit kur i sheh
fytyrat e zgjatura me sy të ënjtur
që e soditin me tallje
pyet veten
kush e solli në këtë akuarium
apo duke ikur nga grepi i artë
hyri vetë
aq shumë kohë ka kaluar
sa s'mban mend

(kësaj i thonë vetmi)
bredh rrugëve të takosh njeri
befas e kap veten si flet me dritare me gjethe me diell
kokëvarur si lavjerrës kthehesh shtegut të rrahur mirë
lagur llërat e pantallonave me vesë mëngjesi
kur bota lozonjare pi kafenë e përgjumur
me duart në xhepa shtrëngon çelësin
të ndryshkur nga djersa
s'hap asnjë derë
vrimat e çelësave veshët gojët kanë zënë myshk
bën kohë kur dyert hapen me zile

(vetmi është kjo jo shëmti)

incizon zërin e vet në magnetofon
tek bën vjershën ose tregimin
polemizon me kadarenë
letrën shokut ia shkruan në shirit
bisedon me renë e kafesë
me duqet në shpuzore
me femrën tek çon dashuri hamshore
e ndjell shiriti
s'ka turp e frikë se s'është i vetmuar në dhomë

(edhe kjo është vetmi)
në banak më këmbë dy pije porosit
banakierit i vjen rëndë të flasë e të pijë
pasi i numëron të gjitha pijet në vitrinë
e rrugët e vetmisë nën këmbë i janë lidhur nyjë
derës ia qep sytë
pret flladin e fjalëve
kokën t'ia shërojë si një aspirinë

(kësaj s'i thonë ndryshe pos vetmi)
derën e shtëpisë e lë hapur
me pritjen e varur si numër në portë
si setër në gozhdë
pret letër ftesë ndonjë aktpadi
aq shumë ka për të thënë s'di cilit si
gjuha i është ngjizur nga lëngu i fjalëve
merimangat gishtat ia kanë zënë mbi makinë
dritaret ia kanë gozhduar me baski

(vetmi është kjo jo krijim)
në tavolinën e punës brejtur nga krimbat
ulet të shkruajë një dhimbje një dëshmi
shkronjat i renditen si thnegla të zeza
fletën ia hanë si ëmbëlsi
iu gjuan prapë dhe prapë fletë
si miq të vonë i gostit

Një gjeth çaji mbaj në gojë

vjen nga vise të largëta ekzotike
i zi në sandëk druri
made in Bota e tretë
si skllav i mbërthyer që pret blerësin
në kolonitë e reja të zbuluara moti

të blejmë në kuti teneqeje
dhe nuk çajmë kokën si u vole
a rritesh në dru si mollë
apo prej tokës mbin si bimë
s'merakosemi si ikin vjelësit
kur vdekja i ndjek si agjent
për ne ti thjesht rritesh në kuti

të këmbejmë me dy metra sintetikë
me një sandëk plumba dhe dy pushkë
që rojë e plantazhit t'i ruajë vjelësit brenda telit
dhe gjumin e padronit nën palmë

vjen të na bashkosh në ora pesë
(apo shtatëmbëdhjetë si i thonë në TV)
mblidhemi rreth çajnikut
që më mirë se bulkthi këngës ia thotë
shëtit nëpër dhëmbët tanë të vënë
tok me fjalët që i hëngri krimbi
gjuhën na e trash dy gishta
sa as të fërshëllejmë mundemi
melodinë e këngës fituese
"Një gjeth çaji mbaj në gojë"
që është hit në radio

kutitë e bukura të çajit
i bëjmë koleksion
madje i ngremë në pop-art
atje larg fëmijëve të vjelësve
po u rranë në dorë
i ruajnë si kuti muzikore

Muri i mbështetjes

Shtrëngoma dorën kur jam i dehur
Dhe mendoj për Kullën e Babilonisë
Jam i palarë dhe i sinqertë
E ngjitem shkallëve të akullta për në qiell
Ku flenë në një shtrat
Mendjemadhi që gërhet në gjumë
Dhe Ciniku me pagjumësi në sy

E në rënça mos më ngrit
Prej se e mbaj mend
Ky është qëllimi im

Mos më lër që dorë e nëmur përtej mjegullës
Të më gjuajë me mëdyshje si poezinë e dështuar
E cila që mbrëmë fle në shporte
Kur jam i larë esëll dhe gënjeshtar
Kur këmbëzbathur e ndiej vesën e mëngjesit
Prej letrës së zhubravitur bëj vjershë

Edhe Ty e dashur
Në të lënça në rrugën me glasa pëllumbash
Kur jam xheloz dhe me tym në kokë
Kthehu këmbëzbathur
Me vesën e mëngjesit mes gishtërinjve
për të m'i njomur buzët e thara nga dehja
Besomë se do të marr për poezi

Monologu i lëneshës

barrë e rëndë Bisha në shtëpi
për shpinën time të lakuar paksa
të banosh në shpellën e Saj
atje ku krevati ngushtohet nga epshet
Bisha e Koktosë është e denjë për dashuri
përballë bishës sime të bukur që e lashë në gjumë
pastaj...
si ta shkruaj ndjenjën
të më prehet një dorë e butë në ije
t`i shoh fjalët si flluska shampanje
që dalin nga goja që flet e s`bërtet

pastaj...
nis të vizatoj
rrugën që çon në një zemër kozmike
që në fund si ai piktori sybisht
t`i freskoj këmbët asaj rruge me vesë
të humbem në një tjetër sferë

pastaj...
e lodhur jam
nga fjalët
pritjet
bandillët
rezja e derës më mbeti në dorë
kjo pritje barrë e rëndë
njerëzit i shoh përmes retrovizorit
qendër erogjene jam bërë e tëra

pastaj...
mbyllem në dhomën e përhime
që m`i ruan me pluhur prekjet
lëkundem e shkundem e përhumbem
e qaj me muzikë
një shpërthim më bën grimë
edhe një
pastaj edhe një...
edhe një

pastaj...

Këngë mëngjesi

Ngrirë me nukturno të shkruara në pikë dite
Gdhiva me të zbardhuar
Tok me këndesat e parë krekacorë
Dhe ia qepa sytë xhamit të lagur
Ngjyra fluoreshente kish hapur krahët
Gjerë e gjatë deri në paskajësi
Semaforët ma bënin me sy
Veturat rendnin si pa kokë
Shpërndanin të përgjumurit në periferi
Kalimtarët mezi mbanin kokat e këputura
Me duar kërkonin xhepat e mbushur iluzione
E në cepa e tyre u shiheshin gazetat
Ilaçi efikas i komunikimit
Në këtë shekull të eklipsit total
Kur nokturnot shkruhen në pikë dite

Dielli i varur majë rrokaqiellit
Shënonte ditën e pazarit
Kur me syza të zeza majë hundës
Këndesat do t'i kërkojë

Lindja e këngës

Të vetmuarit janë si zeroja
Mblidhen
Zbriten
Mbetja gjithherë zero
Kurrë Një
Kurrë Dy
Apo Tre
Zeroja i ndjek
Por zero s'janë

Të vetmuarit kohën s'e hanë thatë
Shkruajnë letra me lot në sy
Dhe kurrë s'i dërgojnë
Vetmia s'vulos letra
Ajo s'ta ka shoqen
Të çon të varesh me vargje
Dhe si pllakë e gërvishtur të përsërit
Kënga lind në vetmi
Kënga lind në vetmi
Kënga lind në vetmi

. . . . . .

Hamburg 92

1. (humbësit)

tokë ranore është kjo tokë
ndërtesat e reja gjithë xhama
të hekurta shikimet e njerëzve
si në pllakatet neonaziste
përplot dyshim
ndaj të nesërmes që ua ofrojnë
ndaj lavdisë së humbësve që s`i harrojnë
ndaj atyre që malli u noton në sy
rëra që u derdhet nën këmbë si klepsidër
ndaj tërë ditën shtrojnë rrjeta hekuri
lotit të vet t`i bëjnë vend

2. (St. Pauli)

impotenca e moralit a shërohet
banesave me plot abazhurë
që bie erë incesti
vajza ia tregon babait gjinjtë e njomë
nënat voajere shikojnë djemtë kah masturbojnë
kutërbon St. Pauli tërë botën
kjo Meke pornografike e të frustruarëve
zihen kanalizimet prej menstruacioneve
rrinë laviret si pulat nën shi
në një harmoni të kushtëzuar
në punë janë mjeshtre të vërteta
edhe në -10 gradë Celsius ato rrinë me brekë
të devotshme tregohen në punë
merren të denja që për kortezhet e tyre
të këputen të gjitha lulet e Hamburgut
fitojnë me neveri harxhojnë me shpresë
në St. Pauli çmimet s'janë të shtrenjta
me buzëqeshje mund të bësh edhe pazar
të del më lirë se në Amsterdam
kur paguajnë janë aq të hutuar
sa ofshamat false nuk iu pengojnë
mjafton që pulat e St. Paulit ve nuk bëjnë
hyjnë symbyllur nëpër një derë
të mos e shohin Hadin makrotë
vetëm kur dalin i sheh të veshur në turq
hindus shqiptarë vietnamezë ermen zanzibaras
japonezë me fotoaparat në qafë....

3. (metro)

sa pare i ke në xhep
a do t'ia vjedhësh kuletën nënës
sa pare i ke në xhep
rrugë për në Indi a mund të marrësh
sa pare i ke në xhep
joint të dobët apo kokain
sa pare i ke në xhep
shtrenjtë është bërë ndërrimi i gjakut
sa pare i ke në xhep
trupin e njomë a do t'ia shitsh turkut
sa pare i ke në xhep
...njëëëë mijëëëë pamjeeee...
...njëëëë mijëëëë pasqyraaaa...
...një mijëëëë valëëëë i shooooh...
sa pare i ke në xhep
të kuqtë e buzëve për shenja astrologjike
mureve të metrosë e harxhon kot
sa pare i ke në xhep
ëndrrat e ditës janë bërë shtrenjtë
sa pare i ke në xhep
....

4. (mbretërit e birrës)

me terrin nën pallton e vjetër
u vihet pas si somnambul
dritave të përgjumura të taksive
që natën mundohen ta shtyjnë tej
llambat e fjetura në shtylla
nga lart e gjuajnë me gur
assesi të kthehet në krevat
me epshet e fikura të gjuajtura nën të
si rroba të palara që i harrojmë
rrugët i ka pa skaj as trotuar
kur rrokulliset shkallëve të metrosë
palltoja e mbron nga lëndimet
aty ku bie e bën një sy gjumë
me syrin tjetër kujton gruan
tek iu rri fëmijëve mbi kokë
rruazat e gjumit me zë të përhumbur ua numëron
me laps që numrat s'i mban në mend
llogarit pijen e nesërme
terri i ka hyrë në sy
enterierit të gjitha banakëve
andaj flet me qiell

5. (vikend)

të shtunave pasditeve edhe ditëve të tjera
i veshur ashtu që të mos dallojë
në kafenetë e pasazheve plot stola
lexoj *Rilindjen* të vjetër dy ditë
pi kafe ekspres që s`lë gjurmë në filxhan
fatin e rrugëve s`mund ta lexoj
në stolat përreth meje
lexon bota gazetat e tyre të mëdha
titujt nga largësia m`i verbojnë sytë
përballë më sodit një evropiane blu
e veshur sipas modës *si më teket*
setër të gjatë burrash me sedër feministeje
me sy e thërras të ulet përballë
vetmia ime e pengon
u pëlqen eleganca gazetën e hollë si e shfletoj
shkruaj më thotë për modë për rokënrol
edhe atje nga vij unë këndohet
Fëmijët e Kosovës i helmojnë në shkollë
ajo s`ka haber

fatin e rëndë ia tregoj atëherë
përmbledhur në ato pak fletë
ajo si me pëshpërimë gjethesh ma kthen

në shikimin tënd mospërfillës
në cigaren që në gishta të varet
në gllënjkat e shkurta të kafesë
shihet vjetërsia vendi yt
më bëhet se ke lindur këtu

qoftë ashtu ashtu qoftë.

Në pyllin e errët të flokut tënd

Këngë dashurie me happy end

Cullak më le në mes të kopshtit
Era ma mori kapelën e ndjenjave
U rit bari m'i verboi sytë
Unë nuk mund ta kositja
Bota sodiste nga dritaret
Qeshnin me mjekrën time grurë
As që ma lexonin në ballë urrejtjen

Në ferk më iku gjumi fijeve të barit
Me duart e gjata hapa shtegun
Duke u kalamendur mora rrugën e qytetit
I përgjakur përreth tavolinës me gota të thyera
Luajta vallen e rëndë të mashtrimit
Gishtave më rridhte i njelmët harrimi

Ti me shaminë e pendimit në kokë
Më kërkoje rrugëve kopshteve trotuareve
Më gjete duke përmbushur ajrin
Të dehur më more për krahu
(kur të preka me bërryl nën gji
u bëra esëll si mëngjesi)
Duke rropatur si gur' i Sizifit
U ngjitëm Kodrës së Diellit
Kur na valuan flokët në Majë
Ta dhashë në pëllëmbë Qytetin

Ditët e qeta në Prishtinë

I.

Radioja këndon si e marrë në një skaj
Këngët e dashurisë flenë mbi tavolinë
Ne të shtrirë mbi batanijen ngjyrë qershie
Vende-vende të djegur nga epshet pa fre
Zgërdhihemi me pëshpërimë gjethesh
Luajmë me gishtat e këmbëve
Është kohë kur dashuria harxhohet si shkumës

I lodhur të shikoj në sy si miop
Me not bretkose zhytem në thellësi
Përzihem me peshqit e ujit të njelmët Lot
(bota e saj dallon nga imja botë)

Ta fal tërfilin e fatit me katër fletë
Ti kërkon më tepër nga unë
Ylberin rreth qafe Lojën e virgjër me fjalë
Çdo gjë që s'e kam në dorë
(imja botë dallon nga botë e saj)

II.

Dua të jem kripë deti
Të shkrihem në trupin tënd të bardhë
Çdo mëngjes të zgjohem vonë përbri teje
I humbur në pyllin e errët të flokut tënd

III.

Ç'mund të them Unë për Ty
Që më shtyn ta dëgjoj njëqind herë një këngë,
Fryma jote më bën të kërthndezem në mesditë
Rrugët e qytetit m'i lidh nyjë nën këmbë
Flokët e Samsonit m'i shkul në ekstazë
Me epshin tënd më frikëson
Ç'mund të them për Erën tënde të femrës
Që më ngjitet në tesha në hundë
S'guxoj të hap dritaren të dal në rrugë
Gishtave ua mjel lëngun e mbetur të dashurisë
Nga erë mëkatesh trupin s'guxoj ta laj
Se më tretesh në ujë më bëhesh flluskë sapuni
Për të mbetur gjallë në jetë të pi nën gji

IV.

Çdo imtësi e mbretërisë sate
Me vlerën e monumentit të pazbuluar

V.

Kur jam me ty shndërrohem në Gojë
Një njeri sa një Gojë
Një njeri që vlen sa Goja
Kishe mall ta dëgjoje atë Gojë
Që fliste fjalë Goje
Që nuk t'i kishte thënë asnjë Gojë
Unë jam Goja që deshi të t'i hajë dhëmbët e Gojës
Unë jam gjuha që rrëshqiste dhëmbëve të satës Gojë
Unë jam Goja që ushqen Gojën

VI.

T'i hapim dyert e zëmrës
Çelësat e ftohtë t'i hedhim në lumë
Dyert e dashurisë t'i lëmë pa zile
Të hyjmë e të dalim pa trokitur
Në këtë kohë na duhen befasi

Ajo kërkon fron

Të njoh të tillë siç je
Të njoh edhe të tillë siç dua me t'njoh
Mbaje në fytyrë atë grim mashtrues
Edhe më tej do të njoh
Ashtu siç dua me t'njoh
Megjithëse di me t'njoh
Të tillë siç dyshon se të njoh
Si dobësitë e mia të njoh
Gjakimi yt është shkëlqimi
Ari fama e së fundi fjala

S`harrohet jehona e takave tuaja
Erdhe të marrësh "Sidartën" e harruar me qëllim
Natë më parë kur ta hoqa shaminë
Lotët kur të binin me shoshë
Sot muret e zhveshura nga tymi i vetmisë
Të duken si tapeta sallonesh aristokrate
Gjërat e shkapërderdhura nëpër dhomë
Mos mendo se i kam renditur me qëllim
Anarkia banon tek unë
Vlera e vetme antike
Kësaj dhome që i mungon
Epshi yt pagan

Nga ritmi i radios që ia thotë si t`i teket
Mobiliet nisin e vallëzojnë rokënrol
Të ftojnë si fshehtësia e fjalëve të mia
Këmba e ndjek këmbën kujdesshëm
T`i njoh si sytë e tu
Që kur të duan lotët lëshojnë
Këmba e djathtë përherë pe lëshon
Kalon vijën
Bëhemi kafshë mitologjike me tri këmbë

Nga përkëdhelja e qafës me hukamë
Nga fjalët delikate të gishtërinjve
Që shpinës i flasin përgjumshëm
Mornicat na çohen si ferra kaktusi

Gjuhën e lëmashkët mirë ta njoh
Edhe shpinën kur ta kthej
Lëkurën time të gërvishtur
Nga ledhatimet me doreza
Me puthje barishtash ma shëron

Ti përnjëmend kërkon vend në fron

Por dije se jam si mbretërit e sotëm
Në dorë kam vetëm penjtë e tu
Dhe krenarinë time shtazarake

Ajo më ushqen

Në mbrëmje si syri yt me bisht
Gjumi i pendesës kur m`i lidh sytë
Derës nuk ia vë drynin e ftohtë
Shpresën lë galuc në prag
Se sot mos vjen Ti në mëngjes
Më sjell gazeta cigare e byrek
Si dje
M`i sjell sytë e lëngshëm
Që më bëhet se në epsh notojnë

Në dhomën e verdhë kaotike kur të hysh
Librat
Teshat
Tavllat përplot bishta cigaresh
Presin duart e tua
Këngët e dashurisë flenë mbi tavolinë
Një cikël i tërë
Shkruar për Ty natë më parë
Të hysh si skile pa trokitur
Se mos ma ndërpret ëndrrën dadaiste
Radion ta lëshosh me zë të ulët
Tingujt melankolikë të kabasë së mëngjesit
Të notojnë lehtë si tym
Edhe më lehtë të hysh nën jorgan
Të ngjitesh për trupin tim
Si magnet
Ligjin e fizikës ta kujtosh
Trupat me pole të kundërta bashkohen
E të mos humbim kohë kush ç`pol ka
Ke trup të zjarrtë
Kam zjarr për dashuri
Kjo mjafton
Si dje

Ti në mëngjes do të vish
Dhomës që bie erë duhani
T`i dhurosh pak aromë të parfumit tënd
Të qeshen muret e mërdhirë nga heshtja
Zemrën të ma çelësh si kutinë muzikore
E unë të qeshem si cinik
Me tinguj të sinqertë
Si dje

Ajo më fanitet

Kur shtrihem mbi shtrat si parazit
Duke dëgjuar hitet muzikore që i vjell transistori
Kur kujtimet nisin t`i valëvitin perdet
Me ritmin e daulleve përzihet trokëllima e takave tuaja
Mbi kalldrëmin e vjetër turk të qytezës sate
Që shtrihet mes lindjes e perëndimit
Ecja jote dramatike trotuareve
Tej të cilave shtrihen vetëm çajtore
Mbretëri meshkujsh që notojnë në tym e teinë
Atje ku ecja jote merret për herezi
Kurvëri
është rëndë kur ata janë më krenar se ti
Të bën hije
Gjymtyrët t`i ngurëzojnë
Të shtien takimet t`i bësh fshehurazi

Kam frikë të t`i shoh duart
Që vendosin lule si mbi varr
Në gotën time plot alga
Ato duar që me frikë ecin flokut tim
Atëherë i mbledh këmbët
Të bëj pak vend
Për të shtruar mbretërinë e vitheve tuaja
Që rrinë si dy buste
Mbi këmbët e tua
Që mes njëmijave t`i njoh
Pastaj ta ndiej erën e parfumit tënd
Emrin që nuk ia di
Më bëhet se është bar i sapokositur pranvere
Kur të lodh e të vë në gjumë...
Me cigare në gojë nis të shkruaj për ty
E shokët kur më lexojnë
Më thonë se bëj retorikë

Ajo fle

ma lëshon dorën për mjedisi
si lumi që rrjedh kah deti

e lodhur një sy gjumë bën
me tjetrin ëndërron ate që s'e ka
një botë të tërë pa anë

dora m'ka mbetur varur si një degë
hiri cigares m'pikon n'qilim
çdo gjë kam ndalur për një çast
s'du që si hi t'm'pikoje kjo magji

mesazhet e zemrës së fjetur m'i përcjell
vetëm gurgullima e gjakut të saj
që rrjedh dejeve të mija

ajo tashmë flenë
fjalët i kanë marë trajtën
e një guri të lëmuar
gur që me rrënie të lirë
humnerës së shpirtit tim
nuk prek në asgjë

fjalët i kanë rënë në heshtje
si një krehër fildishi flokut të gjatë

do të rri të pushoj edhe pak
në thellësinë e shpirtit të saj

Ajo është lëndinë

ishujt rreth detit janë përplot dritë
dielli perëndon më bukur se në Japoni
mbi rërën e gjerë që përflak
bulojnë nga qielli gjinjtë
all nga dielli veror në perëndim
zbardhon kripa nën lëkurën me mornica
gjuhën e lëbardhur të Flokartit kur ndien
nga shëtitë trupit duke e shkrirë

shpinë e njomë shtyp fajin nën rërë
bebëzat e kënaqësisë i zmadhohen në sy
kur sheh tëposhtë kokën e Flokartit
nga zbret mengadalë Kodrës Gjinjve
të pijë ujë në Hurdhën e Kërthizës

dielli ia lëbyr sytë i dridhen gishtërinjtë
është e ndjeshme dhe pa pushtet
duart i zhyt në rërë si në mëkat
kur ndien etjen e Flokartit
duke pirë ngadalë ujë
në Burimin e Errët të lëndinës djerrinë

kur terri u bie mbi shpinë
si pëlhurë mëndafshi titërrues
fshihen në ishujt e vetmisë
atje ku hijet u bëhen një
ku kohën e masin me hapa me pëllëmbë

Intermexo me muzikë

(takimi)

Nën qiellin thellë purpuror
Në dhomën guacë të lyer me mëkate
Tok për një çast ndalëm kohën
Për ta treguar dhe përfunduar dashurinë
Lëngun jetësor me shije mjalti
Mbi atë qetësi dëgjohej muzika
Ndjenjat merrnin flakë si kashta
Pëshpëritjet notonin vesh më vesh
Mbi to klithmat e shthurura
Shponin ajrin si me shpatë
Ritmi sundonte në ne
Ritmi shtrihej mbi ne
Hijet e lodhura djersinin në mur
Dhoma merrte pamjen e fushëbetejës

(ndarja)

Duke matur kohën me frymëmarrje
Rrimë pranë dritares
Në park shohim dy pleq tek bisedojnë
Përngjasin në dy cunga
Fshijnë avullin prej syve
Ndrydhim duqet e cigareve
Të grimosur me të kuqtë purpuror
Dhe malli ngjitet në derë
E shoh si derdhet kur mbyllet ajo
E ndjej në dorezën e ftohtë në dorë

Letra dhe homazh

Letër babait

Vërtet të ngjakam për fije në fotografi
I paskam vijat e njëjta në buzë hundë sy
Por balluket e krenarisë Ti i hodhe prapa
Unë i mbaj të gjatë flokët e kryeneçësisë
Të lëshuar deri te sytë
Mbas deri në shpinë

Në tra e gjeta çantën tënde të meshinit
Ku mbaje plan-programin mësimor gramatikën
Për ty shenjtërinë nënën babanë
Aty futa ca vargje të miat
Që ty kurrë s'do t'i tregoja
Se do të më bëje horr
Ç'është gjithë kjo ironi
Ç'metaforë
Po s'ka rëndësi është kjo vallë vazhdimësi

Ti ia largoje babait tënd gurët nga rruga
Kur shkonte atje ku donte të ishe edhe Ti
E soditje nga skaji me katër sy
Mos vallë pengohej e humbte ekuilibrin
E ta ngarkonte fajin jetim në shpinë
Ishe i fortë ta mbaje në këmbë
Derisa të shtynë të marrësh udhë
Unë nxihem kur ta ndreq veturën e vjetër
Se ia di gjuhën e hekurt
Siç ia dije Ti peshën gurit

Nga unë baba as të mos presësh një të tillë kujdes
S'e ushtrova zejen e gurëve
Kur jashtë bën ftohtë e ti hyn në odën e ngrohtë
Vetëm avullin nga syzet mund të ta fshij

S'jam kopja jote e dytë
As kipci me fytyrë në pasqyrë
Unë jam vazhdimësia e urtisë sate
Mos bëj ndonjë gabim në hartimin tim

Homazh për babanë

Sa herë që më sillesh ndër mend
Kur nëpër shtëpi më ndjek
Shikimi yt i thellë përtej syzeve
Mungesën tënde e shoh në sytë e nënës

Kur Nata e Premte hap dritaret
Për shpirtin tënd të lehtë si prekja
Të lexoj një Ja-Sin në shqipe
Në ballkon xhaxhai të lexon arabisht
Me zërin e tij plot patetikë

Si shpesh ha veten
Pse një herë s`ma the një fjalë të rëndë
Një shuplakë kur isha fëmijë
Që e kisha hak në çdo hap
Unë s`desha të kisha fatin tënd
As të shihja me dioptrinë e syzeve tua
Që i ruaj si një dënim i ëmbël
Të më ndjekin nëpër shtëpi

Kur të kërkoj Ty
Mbyllem në dhomën tënde
Ku e shtypje kohën si bishtin e cigares
Shoh ndryshkun dhe pluhurin
Që me gjuhë lëpin çdo gjurmë të gishtërinjve të tu
Me një frymë pastroj çdo gjë
Librat
Plan-programin mësimor
Aktgjykimet
Për një çast shoh me dioptri
E dora s`më shkon të shkruaj
Bëj rrathë në qiell e në tokë
Muzikën e gishtërinjve e dëgjoj

Kur më vjen gjumi në pasqyrat e krevatit
Lutem ndër dhëmbë për Ty
Së paku me t’pa në ëndërr
Nën trungun e qershisë në oborr
Duke bërë plane për shtëpinë
Për çdo mëngjes zgjohem esëll
Me ndjenjën e fajit nën jastëk
Ëndrrën s`kam kujt t`ia rrëfej
Pa larë sytë e harroj

Borxh shumë të mbeta
Për mua bëre shumë

Sa ishe gjallë
Të të dhuroja së paku një nip
Që do ta ulje në prehër
T`ia tregoje tapitë
Që unë s`doja t`i shihja me sy

Pse s`u pajtova një herë me planet e shtëpisë
E pse për Ty mbeta vetëm fëmijë
Që m`i puthje sytë kur merrja udhë(t)

Shtëpia

Gjyshi im në Lindje
Bëri dhjetë vjet kurbet
Me paratë e fituara
Ndërtoi shtëpi

Baba im në Perëndim
Bëri dhjetë vjet kurbet
Me paratë e kursyera
Shtoi shtëpinë

Ç'më mbetet mua
Vetëm se në atë shtëpi
Të vë një çati
Të mos lëshoje shi

Letër nënës

Mbrëmë nënë këngën e harrova
U mundova po s'mu kujtua
Yjet nisa t'i numëroja
Njërin e harrova
Gabova
S'i rinumërova
Zjarri u tyre sytë m'i verboi

Kështu më ndodh gjithherë nënë
Më humb ylli si ajo delja në Dhiatë
Të tjerët s'i dua por s'më lënë
Rrinë të qetë në qiellin e lyer me mjaltë
E ylli im më ikën e më ikën
Tej të murrmit pyll shndrit

Po ti mos ki merak
Kam këmbë të forta e hap të madh
Pyllin e murrmë do ta pres me shpatë
Atje tej yllin do ta mbërrij
Sytë do t'i ngop me dritën e tij
Kur të kthehem me kalë
Do ta vë në ballë

Letër Lules

Fjalët që dua të t`i them
Janë fjalë që kurrë s`i kam thënë
Fjalë që s`ia kam thënë kujt
Nuk gjenden në asnjë fjalor
Janë fjalë të renditura pa drejtshkrim
Pa presje pikëçuditje pa pikë
Vjershat nuk m`i zënë ato fjalë
Që s`flenë me një mijë e sa librat e mi

Fjalët që dua të t`i them
Janë fjalë si sytë e tu të zezë ullinj
Fjalë që do të notojnë dendësisë së flokut tënd
Për çiltërinë tënde
Që edhe gurin e bën t`i flasë
Fjalë që zogjtë i ngurëzojnë
T`i bëjnë të kapshëm
Trungjet i çojnë të fluturojnë

Fjalët që dua të t`i them
Do të rrjedhin në Ditën e Madhe
Rrëkeshëm e me bubullimë
Si ujëvarat e Mirushës
Fjalë si kometa e Haleut
Me bisht të zjarrtë

Fjalët që dua të t`i them
Fjalë që sjellin orgazëm
Fjalë tik-take
Me shije mjalti që djeg në fyt
Fjalë që i njoh mirë
Të futura në zarfe të adresuar
Fjalë që më rëndojnë
Ma ntrashin gjuhën
Fjalë si pika portokalli në gojën shkrumb

Këto fjalë as Mileri s`ia tha Brendës
Në dy mijë e sa letrat e tij në pleqëri
Fjalët që dua të t`i them
Kanë ngjyrën e zërit të Bono Voxit
Fjalë që më shtyjnë të dezertojë nga barrikadat
E të vijë në gjirin tënd si disident

Letër si vizatim

Më vjen si rrallë me t'shkru
Atëherë të mbledh nga çdo skutë e trurit
Syve gojës gjinjve flokëve u jap shpirt
Me sy largoj mjegullën nga akti yt
Cigaret i ndez një nga një nuk ngopem tym
Me shpirt e dorë bëj bukurshkrim vizatim
Shikimin e kthej në vete thellë në brendi
Ku më lehtë të gjej ty ato buzë këmbë sy
Punë delikate për nervat e mi të këputur pa ty
Se mos më luan brusha dorës ta prish flokun
Për habi ajo nuk dridhet rrëshqet si thika në mjaltë
Ndjenjat derdhen vrullshëm si rrebesh shiu
Nëpër ullukët e çatisë me myshqe jeshil
Ti e di Unë jam piktori yt më i mirë
Që me besnikëri vizaton çdo bisht syri goje
Kërthizën që më mungon kur s'je me mua në dhomë

E di këtë letër do ta lexosh njëqind herë
Ndaj duhet të jetë e sinqertë si poezia që e do
Delikate si pulitja e syve të tu ullinj të zezë
S'jam romantik me t'shkru me laps
Nga shprehia të shkruaj me makinë
Por fjalët janë gjaku im i derdhur në germa plumbi

Dita si një fëmijë me llastikë në dorë
Më gjuan këtu ku s'më rrihet pa ty
Sytë e tu u vulosën në sytë e mi gështenjë
Kur s'je me mua për ty mund të shkruaj
Letër vjershë apo me t'vizatu

Letër ekologjike

dyndja e fqinjit nga fshati
ia hoqi mëdyshjet e shpërnguljes gjyshit nga plisi
zgjodhi një truall në periferi
pos shtëpisë ngriti edhe një stallë
ish mësuar me kuaj lopë këlyshë
edhe këtu stinët ishin po ato
me një shikim nga dritarja i njihja
imazhin e gjyshit për arat e misrit
një tymtar që mbiu aty pranë ia prishi
lejlekët e tradhtuan
mbi të s'ngritën fole
por trumcakët vinin edhe më tej
edhe treni për në fabrikë vinte çdo ditë
mollët bëheshin me krimba
kashtat e misrit jepnin nga një kalli
shtëpia ngadalë përshëndetej nga flora
treti gjithë ai sfond pa kufij
tej shtëpisë mbeti një arë e dy hektarë
me trungjet e prera të misrit me borë
u mbush fusha plot magaze, furra, mbeturina
m'u thye krenaria e ushqyer me tv libra
për në punë të më zgjojë sirena
tymtarët e lartë villnin mbi çati
një orë pasi e laja veturën mbushej xhami hi
fëmija më lindi me bronkit
që s'ia shëron as ulqini
gjyshi jetoi nëntëdhjetë vjet
babai mezi i mbushi pesëdhjetë
unë i kam tridhjetë
dhe stinët i lexoj në kalendar
në dhomë e kam futur trumcakun të më këndojë

Letër shokut të bankës

Shok i harruar i rendit te fundit nga Dritarja
Shoh se vitet ma shtojnë harrimin e verdhë
Koha ma vë kleçkën
Duhet t'i kujtosh bredhjet korridoreve
Zilet e hareshme para kohe
Kur s'hynim në mësim
Kur pinim cigare pas shkolle
Kush na thoshte vagabondë hohshtaplerë sharrëxhinj
Sa vërtet sharronim deri në gozhdë
Por dhëmbët s'na u thyen

A të kujtohet si na mashtronte me fjalë ai i Gjuhës
Ne heretikëve anarkistëve ...
Por s'doli burrë me gjithë 100 kg. në trup
Në albumin e maturantëve
Na i veçoi fotografitë
Ne donim të ishim në fund të albumit
Siç ishim në bankën e fundit nga Dritarja

Po ai i matematikës me distinktivin e Ajshtajnit në jakë
Si habitej kur na shihte në pushim
Duke ngrënë çerekun e bukës thatë
Vërtet hanim ne çka s'hanim
Librat rrobat bankat profesorët
Disa para dreke disa pas
Thatë i hanim si bukën
Apo kohën tonë
Që binte para kohe
Si zilja

Gjuha e sendeve

Krevati i hekurt

Të martën e gjelbër në Pazar
Bleva një krevat të hekurt
Shumë u lodha tek e ngallmova
Gabova kur e mora për ekzotikë

Kur lodhja u shtri mbi të gjerë e gjatë
Vari barkun e kalit deri në tokë
Mori formën e barkës që i mungojnë velat

Në mbrëmje e vesha me mbulesa
Të lara të bardha gëlqere
Orën e dorës ia vara te koka
(përkujtova babanë që i përngjaj)
ora ime ecën pesë minuta para

Në mëngjesin e blertë fije bari
Ndërroi relievin u bë lumë
Pa barkë pa timonier pa ujë

Pasdite kur ktheva i qullur djersë
Më qasi si djalin sugar
Djersën ma thithi me pambuk të bardhë

S'kryqova shumë data në kalendar
Krevati u bë tavolinë magazinë shtëpi
Mbi të haja bukë shkruaja vjersha
Nën të gjuaja rroba të palara libra hermetikësh

Ora e dorës nga harrimi u bë orë muri
Ia maste kohën krevatit ekzotik
Që për inat të kanapesë
Qëndron mbi këmbë të hekurta

Radioja

Heshturazi hyri në dhomë
Renditjen orendive ua ndërroi
Dhe me krenarinë e vet metalike
Ngriti zërin në kupë të qiellit

(ky është dreqi vetë
thoshte gjyshja
që s'pati ku të ikte
dhe hyri në kuti)

Kur radioja nisi të këndonte non-stop
E programova me ritmin tim
Në vend të kafesë së mëngjesit
Ndrydh butonin ON
Ia ndërroj kanalet gjatë ditës
LW, MW/ AM, K / SW, U / FM

Kur veshët m'i mbush muzika
Dëgjoj lajmet me antenë të ngritur
(humbi muhabeti i orëve të vona
kur piqnim gështenja
dhe thanim djersën ditës
thotë gjyshi me mllef nën mustaqe)

Në trekëndëshin e jetës sime
Ka zënë vend në një skaj
Dhe rri si mace e zezë
As që e kujton gramafonin e vjetër
Që u këndon merimangave në tra

Televizori

Në mbrëmjen memece pa asnjë yll në fytyrë
Mërzia si një fëmijë që u rrit para kohe
Ulet në kolltuk ndez cigaren përzjenë çajin
Shkopthat e njelmët i përtyp si vetminë
Flak gjumin që i kacavaret qerpikëve
Dhe ia qepi sytë ekranit lara-lara

Me telepilot në dorë bëhet kolonel
Ndërron programet si pasqyrat
Njëherë të parin
Pastaj të dytin
Por se ku i humb i treti

Pi çajin ndrydh cigaren çohet nga kolltuku
Merr kaçavidën thikën shpatën
Televizorit stoik ia vringëllon para syve
Rropullitë ia nxjerr përjashta një nga një
Ia kërkon sëmundjen tumorin në bark
Ia cakton diagnozën trombozë në dorë

Me vullnetin e Sizifit ngjitet mbi çati
Dorën metalike ia përdredh majtas djathtas
Sërish ulet në kolltuk ha thonjtë e shqetësimit
Shikon programin e parë shikon të dytin
Si me faj mendon për të tretin

Shkumësi

Guximi i vogël është bërë rebel
Nga shërbëtori i shkollës vjedh shkumësat e bardhë
Për të vizatuar mureve dhe mbi asfalt
Diellin e madh
Me sy të buzëqeshur

Kur niset për në shtëpi
Shërbëtori i Madh rrugën ia pret
Xhepat ia bastis
Çantën si shtëpi ia përmbys
Bien librat si nga qielli mbi asfalt
Kërkon palat e çantës si nëpër vitrinë
Shkumësin e tretur mureve me sy

Të nesërmen në shkollë
Guximin e vogël
Para nxënësve Drejtori e nxjerrë
Hajn të shkumësave e shpall
Guximi në një këmbë i mbërthyer për muri
Me duart e vogla pas shpine
Symbyllur
Diellin me sy të buzëqeshur vizaton
Si Pikaso

Qoshku

Gand të del në skaj të rrugës
Mbështjellë me gazetat me slogane
Me gji starletash plot silikon
Xhamat mbuluar paksa me pluhur
Me pllakate elektorale
Me germa plot Evropë
Liri barazi bollëk marrëzi
Me një fjalë kiç politik hipokrizi
Ia zënë shikimin shitësit
Që në ferk ia nis pazari pa të
Sypërgjumur mes gazetave
Gjen paratë e blerësve kalimtarë
Besnikë e të ngutshëm
Kohë që s'kanë të vjedhin as një gazetë
Myshterinjtë nuk i njeh
Kush çka blen për duarsh i sheh
Ushtarët adoleshentët lëneshat pleqtë
Qoshkut një herë i sillen rrotull
Mbledhin rruazat e derdhura të guximit
Për të bërë lakuriqësi pa censurë
Ngushtë e ka shitësi i qoshkut
Mes atij rashamoni të gazetave
Vrasje, vërshim buzëqeshje cinike
Kortezhe shantazhe protesta pa lidhje
Ndaj jep nga një copë nga dritarja e vogël
Sa për të marrë frymë me plot mushkëritë

Gjuha e sendeve

Fjalori i sendeve është i trashë
Për ta kuptuar s'duhet të jesh poliglot
Kanë gjuhë nervoze skofiare melodike
Mund ta kuptojë çdonjëri me sy

Për t'ia njohur gjuhën orës
S'duhet t'ia nxjerrësh vidhat jashtë
Librat kanë gjuhë her (m) etike
Ndaj si shpesh i hedhin në zjarr
Gjuha e radios është kumbuese
Në mes të natës e zgjon një mëhallë
. . . . . .
. . . . . .

Që moti mundohem të mësoj përmendësh
Gjuhën e sendeve memece
Që më mirë kuptohet në heshtje

Dhe në rrofsha sa gjyshi im
Më duket se do të vdes me Fjalor në dorë
Gjuha e sendeve metaforë

Prishtina ime ‘80

Prishtina

Ky qytet është yti posa ta njohësh
Të fut në valle pa shami
Të përqafon të puth në ballë si vëllain
Trotuareve gjarpërore të shëtitë
Kipcin me duar në xhepa ta nxjerrë në vitrinë
Rrugëdalje ke në çdo udhëkryq
Në dyqan fakultet bibliotekë
Mund të hysh nga dyert e daljes
Mund të dalësh nge dyert e hyrjes
Mund të hysh pa trokitur
Nga zhgënjimi troket kur del
Mund të çelësh shtegun tënd
Mbi barin me rrugica – labirint
Se ky qytet (s)është vendlindja jote
Qyteti është i askujt
Asnjëherë s'lindi në të
Çdo i ardhur (s)është i mirëseardhur
Në këtë qytet që rrit shtatin
Qiellin me dorë për ta zënë

Ky qytet herët bie të flejë
Zgjohet edhe më herët se këndesat
S'dihet a zgjohet me diellin
Që lind me nge pas rrokaqiejve
Apo me shiun sixhim që përplaset
Mbi shpatullat e tij betonike

Prishtina ime pesimiste
Historinë e pashkruar s'ta di
Të renë e shkruajnë zemrat e përgjakura
Që ecin dorë për dore
Margjinave të faqes së bardhë
Duke lënë gjurmë prapa
(merrini me mend zemrat e nxjerra nga gjoksi)

Dimri dhe stinët e tjera

I.

Kur marr rrugë të gjatë në Pranverë
Të harroj fare qytet i shkretë
Jepem pas vendeve të huaja si pas grave
Misterioze me buzë në gaz
Pas atyre vendeve që më qasin nga dyert e daljes
Siç i pranojnë gratë e martuara dashnorët gojëmbël
Ti ngel me qetësinë e gruas që pret burrin
Besnike dhe e mundur nga vrazhdësia e tij
Je grua që rrit fëmijët e palindur
Grua që merr e nuk jep nga dashuria
Të paktën një puthje të lëmashkët
Një shikim të butë
A një prekje

II.

Kur marr rrugë Verës
Së pari më kujtohesh qytet i djersitur
Më i ngadalshëm se breshka e kërmilli
Burrë e rëndë që s'luan vendit Ti Prishtinë
Të njoh Unë, Ti vetëm mediton këmbëkryq
Ta njoh heshtjen tënde të priftit
Që hoqi dorë nga epshet e dashurisë
Shumë mirë të njoh asgjë në Ty s'ndryshon
I njëjti qiell stina po ajo
Ndërtesat e reja si përherë apatike
Njerëzit të njëjtit të ngrysur po ata
Refreni gumëzhima me vello tymi
Ndryshimi për Ty është i vështirë

III.

Në Vjeshtë kur largohem nga Ti
Më avullohesh sysh qytet laraman
S'e ke të murrmen rrobave të qyteteve të mëdha
Përhimtësinë që do të më fanitej në renë e çajit
Kudo që do ta pija
S'ditën të t'i zgjedhin rrobat
Gabim ta marrën masën
Shijen s'ta mësuan
Kreatorët të veshën me ngjyra fëmijësh
Karakteri yt ndryshon nga rrobat që mban
Kryeneçësia t'u shndërrua në heshtje kryengritëse
Si kurrë më parë të duhet një arkitekt Sinan i ri

Që do të më kthente sërish mes kofshëve të tua

IV.

Po Dimrit s’mund të ik nga Ti
Më ngjitesh si llohë mëngëve të pantallonave
Nga bardhësia jote verbuese s’mbaj syze të zeza
Jam i lumtur kur ma ndrit kurmin
Kur drita jote ma lëbyr syrin
Kur kthehem në dhomën e këmbëve të nxehta
Kur avulli i gjygymave të çajit më hyn në hundë
Kur plasave të dritares dhe të ndjenjave
Ua mbyll vrimat acari të mos hyjë brenda
Kur me shall të leshtë e lidh kokën për trupi
Duart e mërdhita kur i fus në xhepat e tu të nxehtë
Kur në çdo detaj kërkoj e gjej harmoni planetare
Kur brengën e gjuaj si kutinë e harxhuar të cigareve
Dimri vërtet është stinë parajsë
Stinë e Zotave
Stina jote
Stina ime
Vetëm dimrit mos më nxirr nga mitra jote e nxehtë
Prej banese le të më nxjerrin në acar
Në mesnatë
Do të shëtit me Ty rrugëve të akullta xham

Dhoma e fshehtë

Në Kodër të Diellit zura një dhomë me qira
Një dhomë sa një kuti një dhomë tri me tri shtëpi
Të keqes ia mbylla derën me drynin "Titan"
Shtratin e vendosa përballë Diellit
Në mur gozhdova një thumb
Në të e vara Poetin
Mbi vitrinë nisa t'i rendit miqtë e mi
Tok me ato pak mikesha që kam
Për mistikët s'pati vend i futa nën krevat
Por miqtë e patën ngushtë në vitrinë
Një nga një zunë vend rreth tavolinës
Si te Mikelangeloja ua shtrova Darkën e Fshehtë
Duart i lamë me sapun erë mimoze
Unë si nikoqir i mirë u qita një shishe konjak
Edhe Bukovski e nxori një uiski të lirë nga xhepi
U poqa nga një kafe pa sheqer
Cigaret ua hodha në tavolinë

Nga mirësjellja flisnim me zë të ulët
Pallavra trillime përjetime
Ndjesitë merrnin flakë
Kur flisnim me mall
Sytë na bëheshin strall
Faqet e sytë na u mbushën gjak
Zëri na shkonte në kupë të qiellit
Në një dhomë i gjalli me të vdekurin
Migjeni i thoshte Kadaresë diçka në vesh
Camaj fliste me krenarinë e gegës
Markezi luante me protezën e Melkiadesit

. . . . . .
. . . . . .
. . . . . .

Dikur nga trokitja kumboi dera
Të gjithë miqtë si me porosi sërish ulën zërin
Padiktueshëm dhe pa lamtumirë hynë nëpër fletë
Gojëhapur hapa derën sekrete
Dhe...natyrisht...asgjë
Radioja këndonte "Apasionatën".

Shirat mbi Prishtinë

Kur bën mot me shi dh dyert mbyllen
Era përplas vetminë në dritaren pasqyrë
Durimi epohet si lis në fërshëllimë
Numrat telefonikë i thadrova në tru
65-290 bilbili këndon me zë të shterur pi, pi ...
Alo Baba jam unë mbeta pa para
Në Provim rashë me gojë më mbytën djersët
Por shëndoshë mos u mërzit se do të bëhet më mirë
Baba në album e gjeta një fotos tëndin
Mirë e ka nëna kur thotë se të përngjaj ty
Pas dy javësh vij në shtëpi paçi shëndet
Lëshoj receptorin në shtrat të flemë
Pas një kohe qetësia e tij m'i vret sytë
Jashtë bën mot me shi dhe dyert u mbyllën
Kontakt me botën vë me telefon
28-01 bilbili ia thotë këngës si di ai
Alo Shpirt jam unë a ma njeh zërin jam ftohur
Kam mall me të prek të shkojmë diku
Si të ndalet shiu eja tek unë
Do të përcjell tevona deri në shtëpi
Nëse ndalet shiu mos harro

Receptorin e lëshoj me mëdyshje
Dua të dëgjoj hukamë femrash që s'djallëzojnë
Por sërish mërzia më kap për jake
Durimi më epohet si lis në fërshëllimë
Në lugjet e qeramidheve rrjedh vetmia
Unë dua të bisedoj me shokët
33-392 sa bukur që këndon sot ky bilbil
Alo s'po dëgjohesh mirë (rrotulloje zeron)
Më duhesh për ta korrektuar tregimin
Por në këtë shi që s'ka të ndalur mos u nis të vish
Telefoni sërish r anë gjumë
Në palët e trurit mister kërkoj numrin
Që mund të flasë me gjithë botën përnjëherë
Në këtë kohë kur shiu dritaret trazon

Zhgënjimi nën pallto

Kthehet nga puna me lodhjen bërë shuk si gazetë
Në autobusin urban në këmbë e lexon programin televiziv
Urimet vërshimet gjykimet kapërdin si autobusi rrugën
Lodhja i kapet fortas për mbajtëset qiri
Në dalje merr në thua
Rrugën deri në zemër të banesës e di përmendësh
Dera e hekurt e ashensorit mbyllet si qepallat e tij
Mbi kanape bëhet lojë e çiltër fëmijësh
Një pjesë të lodhjes e lë mbi tryezë pranë kafesë
Orën krenare e mbyll në valixhen e dërrmuar të ndjenjave
I pengon trokitja e zemrës që i derdh vrer
Ngjyrën e shqetësimit e ka të blertë fije bari
Në radion e vjetër kërkon muzikë klasike
Mahlerin Debysinë qetimin cilëndo
I ka miq të vjetër që e vizitojnë rrallë
Radiot e vjetra më shumë flasin se këndojnë
Nervat ia presin me gërshërë fjalët ngulfatëse
Durimin ia merr peng shpresa e mbrëmjes së bardhë
Kryeneçësinë ia shtrëngojnë për fyti
Njëqind e tridhjetë e tri duar metalike me thonjtë e paprerë

Humori i humbi si një unazë martese me mbles
Në palët e arkës së kyçur të problemeve
Çelësi i ra nga vrima e xhepit të grisur
I mbeti vetëm nostalgjia që i fanitej në renë e kafesë
Dhe buzëqeshja ironike

Para darke i lexon copë – copë Gogolin kafkën dhe thotë
Unë s'jam Akakie Akakieviqi as Jozef K.
Jam lojë e fëmijëve të mi duarve të mia të pastra
Jam Ajër Hermetik në Brendi të Piramidës
Dhe s'lejoj të më ekzaminojë asnjë kompjuter

Në mbrëmje me të shoqen del t'i shpijë këmbët
Në vitrina i sheh fëmijët e vet veshur për mrekulli
Rrugës për në banesë i lag shiu deri në palcë
Sonte duhet ta kryej "Pallton" doemos
Nesër gruas do t'i blej një pardesy
Palltoja ime ende është e re
Mund ta përballojë edhe këtë shi

Djersa në diell

Me syza të zeza që rrudhat m'i heqin ballit
Vihem rrugëve si fëmija pas fustanit të nënës
Shoh qytetin si mplaket si përtërihet me nge
Diellin e vjetër si lind kur perëndon
Lutem që retë të mos e mbulojnë qytetin
Sfondin diellor ta ketë plis mbi kokë
Të munden njerëzit të mbajnë syze dielli
Rrudhat t'u ikin ballit të lagur
Djersa t'ia bëjë me sy diellit
Të pikojë qetë mbi asfaltin e ngrohtë
Që kur të shohë në tokë ta çmojë këtë botë

Njerëzit e ndershëm shohin programin e parë

Qytetarë të ndershëm jini gati
Ora e marrëzisë ra shtatë e tridhjetë
Ndrydhni butonin numër Një
Ditari i zjarrtë ju pret
Spikerja e bukur kurrë s'gabon
Zërin dhe kostumet s'i ka barrierë
Me buzëqeshje ironike dhe shkurtimisht
Lajme të reja do t'ju servojë:
Rruzulli tokësor ka zjarrmi
Litarët e meridianëve ia zënë frymën
Njerëzit e ndershëm janë të paktë
Barbarët ua bastardojnë gjuhën
Reporteri nga terreni raporton:
Një qengj i egër ujkut ia turbulloi ujin
Deh së fundi moti nesër:
Do të bëjë mot i tmerrshëm dhe me shi
Ju do të thoni vetëm të mos jetë i rëndë
Vetëm të mos bjerë mbi timen çati

Pas lajmeve PEP-i do t'ju mësojë
Si pengohet kariesi i dhëmbëve
Ju do të pyetni ndërgjegjes ç'pastë i duhet
Apo dhëmbët duhet ndërruar

. . . .

Ju lutem mos bëni marrëzi
Mos e ndërroni programin
Njerëzit e ndershëm e shohin programin e parë

Lindja në kohë të vështirë

Kur armiqtë u bënë pjellë e mendjes
Vetes nisën t'ia nxjerrin gjumin herët
Të shëtitin rrugëve si gogolë
Të frikësojnë fëmijët që pritnin të nesërmen
Me pikla të bardha si çdo fëmijë

Ditën mblidheshin tok në log
Njëri ankohej se ia vodhën një zanore
Tjetri pohonte për një alfabet të tërë
I treti qante për rehatinë e humbur
Për gjumin e ditës nën akacie
Të tjerët s'pata kohë t'i dëgjoja

Të nesërmen sërish u mblodhën në log
Vendosën se ç'do të lindin në sezonin dimëror
Vajza o djem Djem o vajza
Sa djem Sa vajza Apo vetëm djem
Vërtet s'pata kohë t'i dëgjoja deri në fund
Mos ma zini për të madhe
Se ngutesha për në shtëpi
Motra kishte lindur djalë

Spikerja e bukur

Ç`fshihet brenda kësaj fytyre të bukur
prapa fletëve që me qesëndi i mban në dorë
kur ia japin para ditarit t`i lexojë

gjakun e ndien
fletëve si i rrjedh
tek ia zhyt llërat e gardërobës kiç
blerë kush ia ka s`e di
(do ta kthej televizorin bardh e zi)

para pasqyrës së gardërobës
fsheh me panel grimi
rrudhat në sy në cep buze
ndjenjës së fajit ç`do t`i bësh
me ç`grim do ta mbulosh
apo me zë

në orë policore në shtetrrethim
spikerja e bukur posedon leje
e çojnë e bien me limuzinë

Buka

(Podrimes, Konushevcit, Krasniqti, Matoshti, Batonti...)

kur u ngujuat në Rilindje
me grykësinë s'bëja më shaka
s'e shtija mikun si dibranët të hajë për hatër

kur bukën e bëtë barrikadë
atëherë kur u ngjitët në vertikale
ashtu siç zbritën minatorët para jush
bukën e përditshme e haja me faj

vargjet e shkruara në grevë
palosni si aeroplan letre
lëshoni prej katit të shtatë
për ta mbajtur orën e premtuar letrare

1 korrik 1993

Kthimi në Prishtinë

(M. Kelmendit)

u ktheva në Prishtinë
erdha
tek zbritja Veternikut me autobus
këmbë u çova si para flamurit
gjeta vjeshtë në njerëz
rreshta të shkëputur për tmerr
ftohtësi në sy lot të ngrirë
që peshojnë dhembje të ngulfatur
ditët që i numërojnë si tespihe
vetëm numra Prishtinë vetëm lot
këtu mbaron semantika nis epika

plumbat majëtopitur
s'të gjuajtën aq shumë në zemër sa në kokë

rrugës për tek ti më vodhën hajnat
jo kuletën Prishtinë po letërnjoftimin
si t'i frenoj ndjenjat në poezi më thuaj
më thuaj Prishtinë
sa shumë më dhe
një mal dhembje që nuk kalbet
si ftua mbi dollapin e harresës

bimën tënde të mërisë
barojat e rrethojnë
t'i shkulësh dora s'të shkon
këtë bimë dreqi do ta thash

ke marrë një kahe
rruga jote është njëkahëshe
me dru anash
me kore kartmortalesh mbështjellë
ikën gjaku yt i ri Prishtinë
me biletë njëkahëshe në xhep

Korrik 1993

Hyrja në safarin tim

Këngë prozaike

(N. Gjinovcit)

deri kur rrugëve të letërsisë shqiptare
do të enden makina të vjetra
që të lënë në rrugë llërëpërvjelë
duarnxirë
kur në letërsinë shqiptare
do të ndërtohen autostradat e gjëra
që heronjtë e librave pa rrudha në ballë
do të shëtitin me vetura turbo

kur të ngihemi komfor
a do t'i kthehemi lirikës
të shkruajmë për shelgjet rreth autostradës
për këngën e trumcakut
që do të hyjë në veturë
nga xhami që hapet me buton
glasat e pëllumbave në xham
a do t'i fusim në këngë

p.s.
kjo këngë s'ka të bëjë me futurizmin
kjo është vetëm një këngë prozaike
merre si ta marrësh

Poeti ters

blen këmisha të shtrenjta pambuku
për t'shkruar me vrer në karton
pastaj në intervista lëvdohet se shkruan ters
mbi spanjollin e kutive të cigareve
ashtu të lëmuar si lëkurë femre
që rrezja e diellit s'e ka parë me sy
rendit vargje erotike

të martave në Pazar
blen patate mollë gjithfarë zarzavatesh
shkaku i qeseve të përhime
që i palos dhe lëmon me skofi
të vjell motive urbane
duke dëgjuar kitarën e Ray Cooderit
vargjet i rendit si notat muzikore
në partiturat e këngëve të Tome Waits
thotë se shkruan për vete
shkruaj thotë për të më dashur
nuk i beson vjershës
pa e parë të botuar në gazetë
nga vetat në gramatikë
njeh vetëm atë njëjës
ka telashe me drejtshkrimin
ë-jat dhe rr-jat e shtyjnë të hapë fjalorin
pas mesnatës së dehur i vjen një muzë
e lodh e mashtron e shtrin mbi tavolinë
mbi të ejakulon si i famshmi Holms
librat s'ia djegin në turrë
nën embargo s'ia vënë
as i gjen nëpër sirtarët e bibliotekave
rafteve të librarive pluhuri s'i zë
kanë tirazh të vogël s'i gjen lehtë
vetëm redaktorët librat e vet i ribotojnë
librat e tij i gjen si pluhur
shtëpive të dyshimta
të heretikëve anarkistëve kodoshëve
veshjes së tij ekstravagante
i shkon për shtat nihilizmi
ndaj vlerave të gjithmbarshme artistike
kritikëve letrar u flet me cinizëm
gjoja i lëvdon
orëve letrare e zë gjumi nga duartrokitjet
është mizor tiran ndaj vetes kur shkruan
askujt tenton mos t'i përngjajë
sa zor
çrëndomtëson sendet fjalët metaforat

pa ndonjë sistem të vetin strikt
me gjuhën e tij leproze
pështyn në vokabular rustikal
mos i besoni këtij poeti
në lidhjen e shkrimtarëve mos e qasni

Letër redaktorit

(M. Limanit)

si duket redaktor
ti vërtet tallesh me vargjet e mia
ruaju shkronjave të rebeluara
mos ta hanë tavolinën e punës
në mos mundeshin vargjet me t'ba gjá
unë jam edhe më i trentë
sado që në pamje dukem i butë
agmi njeri
por jam finok
kam shokë të trentë të nëntokës
ta presin udhën
ta hupin bukën
mes kafenesë të bëjnë për gazep
andaj unë do të pres
por vetëm edhe një numër të gazetës
pastaj do të këshilloja
nga puna të dalësh
kah dera e sprasme e Rilindjes
këtë mund ta marrësh edhe si kërcënim
në daç edhe poezi
ky është stili im

Gruaja e poetit

poezitë ia lexon e mbrama
shoshitur ia ka metaforat para se t'i mbjell
i kërkon t'i sjell nga tregu
mjaltë mollë ndonjë gjë të mirë
i sjell do simbole dhe retorikë
i kërkon diploma pozitë
gjithçka e tija i duket fluid

mbrëmjeve letrare promovimeve
e merr pas si stoli
ç'fustan të vesh sonte ç'stoli
as që ia sheh në qafë mërzinë
si kravatë mëndafshi që e ngulfat

netëve me ethe kur i humbet
kur nuk i shkon në dhomë
kur s'është duke lexuar librat që i mban nën krevat
shkon e merr në studio si fëmijë
lojës së tij me vargje mbi bukurinë
me ledhatime të përgjumshme i përgjigjet
asgjë të prekshme s'ka në jetën e saj
gjithçka i ndodh si në libra

pasi e lodh e vë në gjumë
për natë të mirë i thotë
mos lexo vonë

Jeta në vertikale

(R. Ahmetit)

diku lart
diku poshtë
as anash
as prapa
as lart as poshtë
maje nuk ka
rrënjët i ëndërron
diku në mes
në një shesh
i vetmuar
pa shteg
në rrëmujë
kërkon ajër
kërkon ujë
gjithherë në kërkim
në një rend pa fund

Ngutej të vdiste i ri

(S. Selimit)

shkurt
shumë shkurt
vërtet në Shkurt
poeti vdiq i ri

me të rrezova
ende pa e lexuar
dhashë e mora

aq shumë bëri
sa pak i dhashë
e jemi nga i njëjti fshat
i rrethuar me gështenjë
që lind poetë

mundimshëm që ia kalonte lindjes
ma hodhi një dru si trap mbi lumë

me sy përplot diell
me tëmthat e qitur si gështenjë
me gjakderdhje në shpirt
fuste në vjershë
Mellcë Çukë e Zabel

në ditën mjegullore
mendimet nuk t'i lexuan
por t'i panë
ndaj dhe të vranë

Rinoqeronti

(*Sh. Mehmetit*)

Rri vetëm në Savanë
Larg turmës së Fisit të vet
Me majën e brirtë të vetmisë
Rrëmih në tokën e tharë
Nëpër Fushë Ugar

Shprush dheun me ngulm
Si një arkeolog fanatik
Kur ëndrra i fle në duart
Deri në llërë të zhytura në thellësi

Rrëmih...
Rrëmih...
Rrëmih...
...në thatësi në vdekje në djerrinë
Kokën kah qielli e çon me nge
Sheh retë që i udhëtojnë në kujtesë
Ëndërron pikat monotone të shiut veror
Që si djersë apo si lot
Më parë do t'i ndiejë në sy
Se në lëkurën e trashë meshin
E të ecë rëndë-rëndë në Savanë
Larg turmës së Fisit të vet
Deri në ylberin që pi ujë në lumë

Demi

(A. Konushevci)

I egër e i murrmë
Gjithnjë në turr
I lodhur si në arenë
Turfullon në një ëndërr
Estokadës i bën bisht
Ende ëndrrën e ka të brishtë

Është bërë për cirk
Rrugëve të Spanjës s'e kanë më frikë
Parmendat janë varur si relikte
S'ka më as Egjipt as Indi

Lëreni të flejë
Është djersitur
Hidhni një plaf në shpinë
Demit të harlisur të arenës
Që pret rendin për në kasaphanë

Pse shkruaj

(Sh. Islamit)

Pasi femra e shokut s'kish letërnjoftim
Ai më pagoi një dhomë në hotel
këmbim për dhomën time
dy me tri
pasi bëra një dush një orë
pasi më rrodhën vargjet vrushkull
ashtu lakuriq në dhomën me ajër të kondensuar
u ula në karrigen e ftohtë
në spanjollin e cigareve që mu sosën shkrova një vjershë
për rrjedhën e ujit kohës jetës
mbytje në ujë
vdekjen e një të panjohuri
në dhomën ku duhej të flija
u lehtësova kur vjershën e fsheha
në syzen e tavolinës nën gazetë
për fatin e saj nuk u brengosa
por sot pendohem pse e hodha firmën në fund
kur isha aq i freskët si gazetë mëngjesi
s'jam nga ata që bëjnë ushtrime stilistike
shkruaj vetëm për tu gënjyer
për t'më dashur
për të rrëfyer
e gjithë kjo është aq e pamoralshme
sa që këtë vjershë në libër zor se do ta fus

Për autorin:

Ramadan Musliu:
Vjershat e Lulëzim Hazirit në esencë janë lirika që i dedikohen problemit të zhvendosjes së njeriut nga një ambient në tjetrin dhe fiksimit të sferës së intelektit, të emocionalitetit dhe të identitetit të tij. Ato sa kanë ironi, aq edhe emocionalitet të pastër, që herë pas here ngjyroset me nga pak tragjizëm. Zakonisht hipersenzibiliteti edhe rezulton në tragjicitet

Poezia e tij që në start ta bën me dije se gjakon mëvetësi tematike, pra këndvështrim autentik të problemeve dhe mëvetësi të shprehjes. Nuk mund të themi se autenticiteti i tij kapërcen jashtë modeleve të njohura, por mund të pohojmë me të madhe se diskursi i tij është i saktësuar dhe si nacionaliteti dhe saktësia e të shprehurit si dhe prirja për një figuracion sa më ekspresiv janë premtuese.

(Rilindja, 1990)

Migjen Kelmendi
Luli u kthye në Gostivar. Por Luli u kthye *i vrarë*! Lulin Prishtina e "vrau bukurie"! Ai e kishte humbur qetësinë e një studenti gostivaras, duke u kthyer atje si njëri nga "të vrarët bukurie" të Prishtinës. (Prishtina është një qytet i tmerrshëm. Në të patjetër do të jesh i vrarë: o bukurie, o policie!)
Shumë kohë, po them, kaloi që atëherë. Ndryshuam ne, Prishtina, ndryshoi Kosova. Bota ndryshoi.
Mes Lulit e Prishtinës, tashti, qe ngritur një mur i madh kufiri.
E dija se Luli nuk mund të qëndrojë pa shkruar, dhe kurrë nuk do të punojë si inxhinier. Më njoftoi për përmbledhjen e re me poezi që e kishte titulluar "Kur dyert hapen me zile". Më tha se në libër e kish ndërtuar një Utopi të re - Letërsinë shqipe me autostrada! ...
Shkova që t'i bashkëngjitëm Utopisë së tij të re dhe t'i falënderohem për gjithë ato vargje me të cilat aq bukur i këndoi qytetit tim, tek i cili, siç tha vetë, duke zbritur Veternikut me autobus – "çohem në këmbë si para flamurit"!
Aq bukur diti t'i këndojë këtij qyteti të tmerrshëm, në të cilin patjetër do të mbetesh i vrarë: o bukurie, o policie!

(Koha, 1995)

Ali Aliu
Përmendëm forcën e rrezatimit të brendshëm që sugjeron prania e metaforës si pagjumësi makondase. Krahasimi pra i pashqiptuar, i brendshëm, metaforik, është tejet kreativ dhe nxit më shumë rrezatime përsiatëse. Por, me këtë rast, fjalën e kam gjetkë. Lexuesit të poezisë, me këtë rast, në shikim të parë, mund të mos i duket i veçantë, aq më pak përmasash kreative të jashtëzakonshme, krahasimi i brendshëm i tillë që, në fakt synon ndriçimin e botës sonë kolektive aktualisht. Për më shumë, lexuesi, ai që është i informuar për shekullin e pagjumësisë dhe vetmisë makondase, mund edhe të mendojë: ka mundur të më kujtohet edhe mua, ta them edhe unë këtë krahasim metaforik. Është,

natyrisht vetëm një iluzion i lexuesit, që, nga ana tjetër, vjen si dëshmi për kreativitetin dhe natyrën spontane të poetit. E tillë duket gjuha në poezinë e Lulëzim Hazirit. Lexuesit i duket sikur bashkëbisedon me një ligjërim poetik, ose sikur dëgjon rrëfejza të zakonshme jetësore, përmes gjuhës më të zakonshme. Ndërkaq, gjuha e poetit, që nga fillimet, gjakon të distancohet sa më shumë nga ajo e komunikimit të rëndomtë. Tek të talentuarit, ky gjakim për distancim bëhet diskretshëm dhe natyrshëm, tek të tjerët ikja duket e kërkuar.
Që gjuha poetike e Lulëzim Hazirit na vjen e lehtë, e qartë dhe e afërt në komunikim, në thelb nuk është rrjedhim i natyrës krijuese që ka prirje narrative, edhe pse, në poezinë e këtij të riu, të themi, të talentuar, vërehen edhe këto premisa. Distancimin në këtë plan, poeti kryesisht e arrin përmes figurës së zhvilluar, globale, që në tërësinë e vet e fut tërë njësinë poetike. Figurshmëria mëton të fokusojë situatë, ambient dhe përmes imazhit global ta komunikojë botën e vet, kryesisht të shqetësuar.

(Flaka, 1995)

Abdullah Konushevci
Lulëzim Haziri me ngulm vjershëron për njërën nga kryetemat e poezisë bashkëkohore – vetminë. Mund të thuhet që, më parë se ndikimi i poezisë bashkëkohore – poetizomi i vetmisë – është një tipar i brendshëm i karakterit të tij introvert, që komunikimin me botën e bën përmes poezisë.
...
Vetmia këtu është më shumë fat a fatum i krijuesit, që dëshiron, që mëton të krijojë një botë më vete, një botë në të cilën do t'i bëhet sfidë sidomos moralit të rremë patriarkal, një botë ku dashurisë do t'i këndohet me të gjitha forcat sa nga malli, aq edhe nga inati.
...
Lulëzim Haziri është pa hamendje njëri nga përfaqësuesit më tipik të brezit të krijuesve të rinj të viteve nëntëdhjetë, i cili nga të parët edhe ka bërë portretin poetik të gjeneratës së vet.
Është ky përgjithësisht një brez i dëshpërimeve e zhgënjimeve të thella, si me vlerat morale, profesionale, politike e atdhetare të brezit më të vjetër. Nuk është e çuditshme, prandaj, pse ky brez është gati totalisht i dezangazhuar, plotësisht mospërfillës për çdo ndërmarrje, tërësisht i shkëputur nga jeta e përditshme.

(Rilindja, 1995)

Mufail Limani
Paralajmërohet si poet i gjeneratës së pjekur me rokenroll (nëse këtë e kuptojmë si fenomen kulturor, jo vetëm thjesht muzikor), me diçka **jashtë** normave dhe **kundër** normave të hapësirës sonë kulturore; në një mënyrë, më duket se Lulëzim Haziri, për dallim nga poetët e gjeneratës së re, është i rrallë ose i vetmi që nuk turpërohet nga rinia e tij, në të gjitha kontekstet e mundshme të kësaj fjale. Mosturpërimi e ruan nga prekja fatale me seriozitetin e pjekurisë që vrapon pas çështjeve metafizike e aktuale përnjëherë, duke e shkëputur poezinë nga marrëdhëniet mashkull-femër e që përndryshe është bërë si e tejkaluar në poezinë tonë, pra erotika si "çështje" themelore, si temë "rehabilitohet" së

bashku me sensin e kohës së jetesës së tij, ndërsa rrethanat e qeniesimit tonë me mjeshtri artistike i privon nga epika e madhe, duke i përditësuar, duke i zbërthyer në çaste dhembjet që kërkojnë gjerësi proze, por që këtu redukohen, në poezitë e rëndomta me tematikë të tillë, në vargje që ngarkohen dhe që humbin vetinë e parë të bukurisë artistike të të shprehurit me fjalë: vetëvetishmërinë. Dhembjet në këto vjersha nuk janë të reduktuara, edhe "klithmat" e kohës dalin në mënyrë të shlirshme, mënyrë kjo që, ta parafrazojmë T. S. Eliotin, me ekuivalencën e tyre emocionale mbërrijnë thellësinë e mendimeve të kësaj kohe.

(Zëri, 1990)

Përmbajtja

1. Rock And Roll
Dyshimi pingul mbi kokë
2. Lutje
3. Në barrikada
4. Kush flet atje
5. Etër e bij
6. Heroi i heshtur fërshëllen një kaba në E-Dur(im)
7. Mos incizo
8. Klounët poetik
9. Dëshmitari
10. Nuk më lënë ta puth dyshimin në ballë
11. Shqipëria
Peshk i vetëm në akuarium
12. (prolog)
13. (kësaj i thonë vetmi)
14. (vetmi është kjo jo shëmti)
15. (edhe kjo është vetmi)
16. (kësaj s'i thonë ndryshe pos vetmi)
17. (vetmi është kjo jo krijim)
18. Një gjeth çaji mbaj në gojë
19. Muri i mbështetjes
20. Monologu i lëneshës
21. Këngë mëngjesi
22. Lindja e këngës
Hamburg 92
1. (humbësit)
2. (St. Pauli)
3. (metro)
4. (mbretërit e birrës)
5. (vikend)
Në pyllin e errët të flokut tënd
23. Këngë dashurie me happy end
24. Ditët e qeta në Prishtinë
25. Ajo kërkon fron
26. Ajo më ushqen
27. Ajo më fanitet
28. Ajo fle
29. Ajo është lëndinë
30. Intermexo me muzikë
Letra dhe homazh
31. Letër babait
32. Homazh për babanë
33. Shtëpia
34. Letër nënës
35. Letër Lules
36. Letër si vizatim

37. Letër ekologjike
38. Letër shokut të bangës
Gjuha e sendeve
39. Krevati i hekurt
40. Radioja
41. Televizori
42. Shkumësi
43. Qoshku
44. Gjuha e sendeve
Prishtina ime '80
45. Prishtina
46. Dimri dhe stinët e tjera
47. Dhoma e fshehtë
48. Shirat mbi Prishtinë
49. Zhgënjimi nën pallto
50. Djersa në diell
51. Njerëzit e ndershëm shohin programin e parë
52. Lindja në kohë të vështirë
53. Spikerja e bukur
54. Buka
55. Kthimi në Prishtinë
Hyrja në safarin tim
56. Këngë prozaike
57. Poeti ters
58. Letër redaktorit
59. Gruaja e poetit
60. Jeta në vertikale
61. Ngutej të vdiste i ri
62. Rinoqeronti
63. Demi
64. Pse shkruaj
Për autorin